



**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE
KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

**BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)**

QERSHOR 2026

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin qershor 2026 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI) dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara, dhe në disa raste edhe ato të dyshuara dhe të mundshme sipas përkufizimit të rastit.

1. Sëmundjet diarreike

Për muajin qershor incidenca e sëmundjeve diarreike është 419.4 raste për 100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike me incidencë 418.8/100.000 banorë.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidenca e sëmundjeve diarreike për muajin qershor 2026
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste qershor 2026	Incidenca qershor 2026 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	13	0.54
Shigeloze (Disenteri bacilare)	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	1	0.04
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	10061	418.8
Sëmundje diarreike në total	10075	419.4

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar në total 240 raste të dyshuar me variçelë (incidenca 9.9/ 100.000 banorë). Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH-ja e Tiranës me 82 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 139 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjatë muajit qershor janë raportuar 27 raste të dyshuara nga të cilët janë konfirmuar 20 raste nga ana laboratorike me metodën ELISA. Incidenca në muajin qershor është 0.8 raste /100.000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së fillimit të rashit



Siç shihet edhe nga kurba epidemike, ka një trend në rënie të rasteve gjatë muajit qershor.

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Dibër	2	3.9

Korçë	1	1.6
Kurbin	2	5.8
Tiranë	15	2.5
Total	20	0.8

Rastet i përkasin kryesisht bashkisë Tiranë, por incidencën më të lartë e ka bashkia Kurbin me 5.8 raste/100.000 banorë.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruthit sipas grup-moshës

Grup-mosha/vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç	10	8.9
5-14 vjeç	1	0.4
15-24 vjeç	4	1.4
25-44 vjeç	5	0.9
45-59 vjeç		
60 + vjeç		
Total	20	0.8

Shumica e rasteve janë të grup-moshës pediatrike 0-4 vjeç: 8 raste (40%) janë të pavaksinuar, 3 raste (15%) janë me dy doza vaksine FRP, 3 raste (15%) me një dozë dhe 6 raste (30%) nuk iu dihet statusi i vaksinimit. Të dhënat e vaksinimit janë verifikuar në sistemin elektronik të informacionit mbi vaksinat (SIV).

Gjithashtu 17 (85%) raste janë të shtruar në spital, ndërsa 3 (15%) prej tyre u ndoqën në rrugë ambulatorë.


Hetimi epidemiologjik i rasteve është kryer nga shërbimi i epidemiologjisë në NJVKSH-të përkatëse, ku janë identifikuar kontaktet dhe janë marrë masat e kontrollit të infeksionit.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin qershor janë raportuar 20 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në këtë muaj është 0.8 raste/100.000 banorë në vend.

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve/100.000 banorë (Incidenca)



Prej tyre sipas gjinisë janë 10 raste meshkuj (50%) dhe 10 femra (50%).

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100.000 banorë) me HBV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Berat	2	3.2
Elbasan	1	0.9
Mat	2	11.5
Poliçan	1	11.4
Tiranë	14	2.3
Total	20	0.8

Në muajin qershor rastet janë të shpërndara në disa bashki (tab 1) ku numrin më të lartë e ka Tirana me 14 raste, ndërkohë incidenca është më lartë në Mat me 11.5 raste /100.000 banorë.

Tabela 5. Shpërndarja e rasteve dhe incidencës (raste/100.000 banorë) me HBV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha/vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	10	1.70


45-59 vjeç	4	0.82
60 + vjeç	6	0.90
Total	20	0.83

Rastet në muajin qershor i përkasin grup-moshës adulte (tab.2) dhe ka mungesë të tyre në grup-moshat pediatrike, kjo në sajë të vaksinimit ndaj HBV në këto grup-mosha. Incidenca është më e lartë në grup-moshën 25-44 vjeç dhe përkatësisht 1.7 raste për 100.000 banorë. Të gjitha rastet e konfirmuara të raportuar janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut B.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin qershor janë raportuar 6 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV-së për këtë muaj është 0.2 raste /100.000 banorë.

Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve/100.000 banorë (Incidenca)



Katër raste (66.6%) i përkasin gjinisë mashkullore dhe 2 raste (33.4%) asaj femërore.

Tabela 6. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Bulqizë	2	7.5
Tiranë	4	0.7
Total	6	0.2

Numri më i lartë i raportuar është në bashkinë Tiranë (4 raste).

Tabela 7. Shpërndarja e rasteve dhe incidencës me HCV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha/vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç	1	0.35
25-44 vjeç	2	0.3
45-59 vjeç	3	0.6
60 + vjeç		
Total	6	0.2


Gjatë muajit qershor, rastet janë të shpërndara në grup-moshat adulte ku incidenca më e lartë i përket grup-moshës mbi 45-59 vjeç me 0.6 raste /100.000 banorë.

Të gjitha rastet e konfirmuara të raportuar janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut C.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit qershor 2026 janë kryer **37 ekzaminime** për HIV (22 meshkuj dhe 15 femra) prej të cilëve 15 raste (11 meshkuj dhe 4 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv.

Grafiku 5. Shpërndarja e testeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është: **5 raste** Tiranë, **3 raste** Durrës, **2 raste** Korçë, **1 rast** Vlorë dhe **4 raste me shtetësi të huaj (me vendbanim të përkohshëm në vendin tonë)** (Grafiku 5).

Grafiku 6. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara




Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 2 raste i përkasin grup-moshës 16-24 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 25-34 vjeç, 5 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 3 rast i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç, 2 raste i përkasin grup-moshës 55-64 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës mbi 65 vjeç dhe 1 rast është me moshë të panjohur.

Rastet e konfirmuara janë referuar si më poshtë: 7 raste vijnë nga laboratorë/spitale private (2 raste GENIUS, 1 rast CAMBRIDGE, 2 raste PEGASUS, 1 rast SWISS MEDICAL, 1 rast nga Doctors Hospital), 2 raste vijnë nga Klinika Ambulatore Infektiv, 2 raste nga Shërbimi Infektiv /QSUT (pavionet), 2 raste nga BKTGJ, 1 rast nga SUSM, 1 rast vullnetar u paraqit në ISHP.

Sifiliz 2026

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 8 raste të konfirmuara me Sifiliz, incidenca është 0.33 raste për 100.000 banorë.

Grafiku7. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Rastet e raportuara, të konfirmuar janë 7 meshkuj e 1 femër. Rastet vijnë nga bashkitë: Tiranë, Vlorë dhe Durrës.

INFEKSION NGA GONOKOKU SI GONORREA, ETJ. (N. GONORRHOEAE)

Gjatë muajit qershor është raportuar një rast i konfirmuar me N. Gonorrhoeae nga bashkia Tiranë, grup-mosha 25-34 vjeç.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar gjithsej 13 raste me tuberkuloz (TB). Sipas lokalizimit, 10 raste janë pulmonare dhe 3 raste ekstrapulmonare. Nga totali, 12 janë raste të reja dhe 1 rast është Recidiv. Rastet përfshijnë 8 meshkuj dhe 5 femra, me moshë mesatare 52 vjeç (21–84 vjeç), ku 9 raste i përkasin zonës urbane dhe 4 zonës rurale.

Rastet pulmonare (10) janë shpërndarë sipas vendbanimit, si më poshtë: 3 raste në Tiranë, 3 në rrethin/qarkun e Korçës (prej të cilave 1 rast në Bilisht dhe 1 rast i regjistruar në burgun e Korçës), 1 në Durrës, 1 në Mat, 1 në Berat dhe 1 në Elbasan.

Rastet ekstrapulmonare (3) janë regjistruar përkatësisht: 1 rast në Tiranë, 1 në Shkodër dhe 1 në Lushnjë.

Përsa i përket konfirmimit laboratorik nga të dhënat e deritanishme, 8 raste janë të konfirmuara bakteriologjikisht (7 me mikroskopi direkte pozitive dhe 1 me kulturë pozitive), ndërsa 5 raste janë diagnostikuar në bazë klinike dhe radiologjike. Ndër rastet e testuara për rezistencën ndaj

rifampicinës nuk u evidentua rezistencë, me përjashtim të 1 rasti me rezistencë të konfirmuar ndaj streptomycinës (STR) në Tiranë.

Konfirmimet dhe diagnozat janë vendosur kryesisht në Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi" (11 raste) dhe në dispanseri (2 raste), mbi bazën e rekomandimeve të dispanserive dhe të NjVKSh-ve të rretheve përkatëse.

Për të gjitha rastet janë njoftuar dispanseritë përgjegjëse, për të kontaktuar me familjarët e pacientëve dhe nisur kontrollin në vatër. 12 nga 13 pacientët kanë nisur trajtimin sipas skemës terapeutike përkatëse.

Nga shpërndarja gjeografike vërehet, se ngarkesa më e lartë e TB-së për këtë muaj është përqendruar kryesisht në rrethet e Tiranës dhe Korçës.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 8. Shpërndarja e zoonozave në muajin qershor 2026, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Qershor(raste 2026)	Incidenca (raste/100.000) 2026
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	11	0.46
Leptospirozë	0	0.00

Për muajin qershor janë raportuar 11 raste Brucelozë përkatësisht: 1 në Korçë, 1 në Përmet, 3 në Tepelenë, 4 në Gjirokastrë, 1 në Kukës dhe 1 në Dibër.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 2 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin qershor është 0.08 raste /100.000 banorë.

Gjatë muajit qershor 2026 është raportuar zero raste vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 100% (2 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.2 Grip

Gjatë muajit qershor janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 106 raste të dyshuara me Grip, nga të cilat asnjë rast nuk ka rezultuar pozitiv për grip.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Meningit bakterial

Gjatë muajit qershor 2026 janë raportuar 2 raste me meningit bakterial, përkatësisht nga Shërbimi i Pediatriisë QSUT dhe 1 rast nga Spitali Rajonal Fier. Shërbimi i Pediatriisë në QSUT ka raportuar 1 rast me meningit bakterial, i përket gjinisë mashkullore, grup-mosha 5–9 vjeç, me vendbanim në Tiranë. Spitali rajonal Fier ka raportuar gjithashtu 1 rast me meningit bakterial, i përket gjinisë mashkullore, grup-mosha 55-64 vjeç, me vendbanim në Patos.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK
DEKSI